



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

UDHËZUES

**Për Shturjen ligjore të KEDS /Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
nga KEDS Furnizuesi Publik**

Prishtinë, 29 Prill 2014



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, neni 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16, neni 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, dhe nenin 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr .03/L –201, në seancën e mbajtur me 29 prill 2014, miratoi:

Udhëzuesin për Sthurje ligjore të KEDS/Operatori I Sistemit të Shpërndarjes nga KEDS Furnizuesi Publik

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Fushëveprimi dhe qëllimi

1. Sipas nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duhet të hartoj dhe të dërgoj Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për aprovim Programin e Pajtueshmërisë i cili do të përcaktoj aktivitetet në lidhje me shturjen ligjore prej të gjitha aktiviteteve tjera të energjisë që i kryen.
2. Sthurja ligjore është e nevojshme që të eliminohen subvencione të tërthorta ndërmjet aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik, dhe të monitorohet nga ZRRE bazuar në nenin 14 paragrafi 2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
3. Ky udhëzues përcakton:
 - 3.1. Përmbytjen e Programit të Pajtueshmërisë i cili do të hartohet nga i licencuari- KEDS OSSH,
 - 3.2. Procesin e shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të Programit të Pajtueshmërisë nga ZRRE.
4. Pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi janë Shtojca A - Plani i veprimit dhe Shtojca B- Baza ligjore dhe Interpretimi ligjor.

Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimet

1. Përkufizimet e mëposhtme, kanë kuptimet si në vijim:
 - 1.1. **“Ndërmarrje e ndërlidhur”** nënkupton një ndërmarrje elektro-energjetike e cila ka në pronësi të përbashkët Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-në) dhe Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE). KEDS është subjekt juridik i cili përbëhet nga OSSH dhe FPEE dhe i njëjti subjekt juridik zotëron interesa kontrolli si në OSSH ashtu edhe në FPEE.
 - 1.2. **“KEDS”** nënkupton Kompaninë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike;
 - 1.3. **“Bordi”** nënkupton Bordin e ZRRE-së;
 - 1.4. **“Komisioni i Pajtueshmërisë”** nënkupton komisionin e krijuar nga Bordi i Drejtorëve të KEDS, i cili do të themelohet në përputhje me nenin 8 të këtij udhëzuesi;
 - 1.5. **“Operator i Sistemit të Shpërndarjes”** (OSSH) nënkupton ndërmarrjen energjetike të licencuar përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë



të caktuar, si dhe ku është e mundur, interkonektorët e tij me sistemet tjera si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike

- 1.2. **"Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike"** (FPEE) nënkupton ndërmarrjen e energjisë elektrike të licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik me energji elektrike;
 - 1.3. **"Furnizuesit"** nënkuptojnë ndërmarrjet e energjisë elektrike të licencuara për të kryer furnizimin me energji elektrike, duke përfshirë FPEE-në;
 - 1.4. **"Zyrtar i Pajtushmërisë"** nënkupton të punësuarin e OSSH-së i cili përzgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të KEDS-it që të mbikëqyrë implementimin e programit të pajtushmërisë.
2. Përkufizimet tjera të përdorura në këtë udhëzues kanë kuptimet si në Ligjin për Energji (03/L-184), Ligjin për Energji Elektrike (03/L-201) dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (03/L-185).

KAPITULLI II PROGRAMI I PAJTUESHMËRISË

Neni 3 Përmbajtja e Programit të Pajtushmërisë

1. Programi i pajtushmërisë duhet të përshkruaj aktivitetet e ndërmarra nga OSSH për të siguruar:
 - 1.1 Qasje jo-diskriminuese në informata që OSSH i siguron nga Furnizuesit;
 - 1.2 Trajtim jo-diskriminues për të gjithë Furnizuesit dhe pjesëmarrësit tjerë në treg;
 - 1.3 Që informatat konfidenciale ose komercialisht të ndjeshme dhënë OSSH-së nga Furnizuesit, nuk i janë vënë në dispozicion Ndërmarrjes së Ndërlidhur, përveç kur është e nevojshme për arsye operative ose ligjore;
 - 1.4 Pavarësinë vendimmarrëse të menaxhmentit të OSSH-së nga Ndërmarrja e Ndërlidhur;
 - 1.5 Identitetin korporativ të veçantë të OSSH-së nga Ndërmarrja e Ndërlidhur; dhe
 - 1.6 Mbikëqyrje efektive dhe monitorim të Programit të Pajtushmërisë.

Neni 4 Pavarësia Menaxhuese

1. Menaxhmenti i OSSH-së do të ketë kompetenca të plotë vendimmarrëse.
2. Dispozitat në këtë nen nuk kufizojnë të drejtat e kompanisë e cila ka në pronësi OSSH-në, që të vendos kufizime të arsyeshme për nivelin e borxhit, planit financiar dhe strategjinë, normat e synuara të kthimit si dhe masa të ngjashme për të mbrojtur të drejtat e tyre ekonomike, në përputhje me nenin 15 paragrafi 4 i Ligjit për Energji Elektrike.
3. Shpërblimi dhe vlerësimi i performancës së menaxhmentit të OSSH-së duhet të kufizohet vetëm në performancën financiare, komerciale dhe teknike të vetë OSSH-së, dhe nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me performancën e Ndërmarrjes së Ndërlidhur.



Neni 5 Ndarja e Llogarive

1. Sipas Programit të Pajtushmërisë, OSSH¹ dhe FPEE kërkohet që të mbajnë llogari të ndara financiare dhe të audituara për aktivitetet e tyre të licencuara.
2. Ky detyrim është shtesë ndaj detyrimeve të cilat mund të vendosen sipas Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit të nxjerra nga ZRRE.

Neni 6 Shërbimet e përbashkëta

1. OSSH dhe FPEE mund të kenë shërbimet që përdoren nga të dy të licencuarit, siç janë por pa u kufizuar shërbimet e TI (teknologjisë informative), ligjore, prokurimit, administratës, financave dhe transportit.
2. Shërbimet e përbashkëta do të kryhen nga OSSH ose kompania e cila e ka në pronësi OSSH, bazuar në marrëveshjen e cila do të lidhet për shërbimet e përbashkëta në mes të OSSH-së dhe FPEE-së. Kushtet e marrëveshjes, pagesat dhe elementet tjera do të përcaktohen në marrëveshjen e cila para nënshkrimit do t'i dërgohet ZRRE-së për aprovim.

Neni 7 Identiteti korporativ i OSSH-së

1. Sipas Programit të Pajtushmërisë, nga OSSH kërkohet që të siguroj se ruan një identitet korporativ të veçantë nga FPEE.
2. OSSH-ja nuk duhet të ketë të njëjtin emër, logo, simbol apo shenjë tjetër identifikuese korporative FPEE.
3. Punonjësit e OSSH-së duhet të kenë shenja identifikuese të veçanta nga FPEE.

Neni 8 Komisioni i Pajtushmërisë dhe Zyrtari i Pajtushmërisë

1. Nga KEDS kërkohet që të themeloj Komisionin e Pajtushmërisë i cili do të ketë përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe implementimin e shturjes ligjore sipas Planit të veprimit të bashkangjitur në Shtojcën A të këtij udhëzuesi.
2. Kur shturja ligjore e OSSH-së dhe FPEE-së përfundon, Komisioni i Pajtushmërisë do të pushoj së ekzistuari. Mbikëqyrja e Programit të pajtushmërisë do të kryhet nga Zyrtari i Pajtushmërisë i cili emërohet nga Bordi i Drejtorëve KEDS-it

¹ Ligji për Rregullatorin e Energjisë, në nenin 46(3), kërkon që ndarja e llogarive të bëhet "më ose para datës 31 dhjetor 2014". Licenca e OSSH-së, në nenin 2, kërkon që i licencuari të ndajë biznesin e tij të shpërndarjes nga biznesi tjetër i tij në mënyrë të menjëhershme. Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit të nxjerra nga ZRRE po ashtu kërkojnë ndarjen e llogarive të OSSH-së dhe bizneseve të tjera që ndërmerren nga i njëjti subjekt juridik. Afati i shturjes bazuar në Marrëveshjen e Energjisë e nënshkruar në mes të R. Kosovës dhe R. Serbisë është përcaktuar të jete 1 Korrik 2014.

Për më tepër Marrëveshjet e nënshkruar me datën 8 Maj 2013 në mes të Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë KEDS për privatizimin e Shpërndarjes dhe Furnizimit publik, kanë përcaktuar shturje ligjore në afatin 1-vjeçar.



Neni 9 Ankesat

1. Programi i Pajtueshmërisë do të përmbaj dispozita që kanë të bëjnë me të drejtën e ankesës në OSSH lidhur me mos respektim të programit.
2. Kur një ankues është i pakënaqur me veprimet e ndërmarra nga OSSH-ja, në përgjigje të ankesës së tij, ai mund të paraqesë ankesë në ZRRE.
3. OSSH duhet të mbaj një regjistër të të gjitha ankesave të pranuar, masave të ndërmarra për të zgjidhur ankesat si dhe veprimet e ndërmarra. Regjistri do të dorëzohet ZRRE-së brenda 30 ditë kalendrike pas përfundimit të çdo viti.

Neni 10 Publikimi i Programit të Pajtueshmërisë

1. Nga OSSH kërkohet të publikojë Programin e Pajtueshmërisë në faqen e tij zyrtare elektronike.
2. KEDS duhet të përkujdeset se punonjësit e FPEE-së janë pajisur me një kopje të Programit të Pajtueshmërisë..

KAPITULLI III MIRATIMI, RAPORTIMI DHE HETIMI

Neni 11 Miratimi dhe Shqyrtimi i Programit të Pajtueshmërisë

1. OSSH do t'i dorëzoj propozimin e Programit të Pajtueshmërisë ZRRE-së, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzuesi.
2. ZRRE do të japë komentet e saj, nëse ka, për programin e propozuar brenda 30 ditëve nga dorëzimi i tij.
3. Pas shqyrtimit, Bordi i ZRRE-së do të aprovoj Programin e Pajtueshmërisë.
4. OSSH, sipas vlerësimit, mund të propozojë ndryshime në Programin e Pajtueshmërisë në çdo kohë. Ndryshimet e tilla të propozuara, së bashku me një shpjegim për arsyeshmërinë, do t'i dorëzohen ZRRE-së.
5. ZRRE, kur e konsideron të nevojshme për funksionimin më efikas të Programit të Pajtueshmërisë, mund ta urdhëroj OSSH-në, që të propozojë ndryshime të Programit të Pajtueshmërisë dhe t'i dorëzoj ato në ZRRE. Kur lëshon një urdhër të tillë, ZRRE do të përshkruajnë arsyet që e shtynë atë të kërkojë që të bëhen ato ndryshime si dhe natyrën e pritur të ndryshimeve.

Neni 12 Raportimi për Programin e Pajtueshmërisë

1. OSSH do t'i dorëzojë ZRRE-së, jo më vonë se me datën 31 janar të çdo viti, një raport mbi funksionimin e Programit të Pajtueshmërisë në vitin paraprak kalendrik. Raporti do të paraqitet në një format të përshtatshëm për publikim, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
2. Në rast se raporti përmban informata konfidenciale, OSSH do të sigurojë një version të plotë të raportit për shqyrtim nga ZRRE-ja, ndërsa një version të veçantë, i cili nuk përmban informata konfidenciale, do ta publikoj në faqen e tij zyrtare elektronike.



3. Raporti do të nënshkruhet nga Drejtori Menaxhues i OSSH-së dhe nga Zyrtari i Pajtueshmërisë.
4. Ky raport do t'i nënshtrohet monitorimit nga ZRRE në përputhje me procedurat e monitorimit.

Neni 13 Hetimi

1. ZRRE mund sipas vlerësimit të vet ose në përgjigje të një ankese nga një palë e prekur, të kryej hetime ndaj zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë të OSSH-së.
2. Nga OSSH kërkohet të vë në dispozicion të gjithë dokumentacionin, qasjen në objektet e saj, qasje te punonjësit e saj dhe kontraktorët e saj, siç mund të kërkohet nga ZRRE për qëllimet e hetimit.
3. ZRRE do të publikojë raportin e hetimit të saj në faqen e saj zyrtare elektronike, përveç informatave konfidenciale. Raporti do të përmbaj:
 - 3.1 Arsyet e hetimit;
 - 3.2 Çfarëdo shkelje të Programit të Pajtueshmërisë të identifikuar si rezultat i hetimit si dhe masat administrative dhe gjobat e shqiptuara nga ZRRE ; dhe
 - 3.3 Çfarëdo kërkesë për ndryshim për t'i trajtuar të metat e identifikuara si rezultat i hetimit.
4. OSSH-së do t'i jepet një mundësi t'i komentoj draft raportin para publikimit të tij dhe mund të paraqes kërkesë për mospublikim të informatave konfidenciale.

KAPITULLI IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14 Gjuha Zyrtare

Ky udhëzues nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjeve midis versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.

Neni 15 Interpretimi

Në rast të pasigurisë në lidhje me cilëndo dispozitë të këtij udhëzuesi, Bordi do të japë sqarime.

Neni 16 Hyrja në Fuqi

Ky udhëzues hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar.



Shtojca A² Plani i Veprimit

Nr	Veprimi	Subjekti i veprimit	Afati	Koment
1	Themelimi i Komisionit të Pajtuëshmërisë	KEDS - OSSH	Menjëherë pas pranimit të Udhëzuesit	
2	Caktimi i Zyrtarit të Pajtuëshmërisë (në KEDS OSSH)	Bordi i Drejtorëve i KEDS-it.	Pasi të përfundoj pika 1 dhe 3 i këtij plani të veprimit.	ZRRE vlerëson se Zyrtari i Pajtuëshmërisë mund të emërohet edhe para se të përfundoj procesi i shthurjes, pasi do të ishte e dobishme që të merr pjesë në procese sa më herët që është e mundur.
3	<p>Përgatitjet për ndarjen ligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndarja e aseteve në mes të OSSH dhe FPEE; - ndarja e stafit në mes të OSSH dhe FPEE , - emërimi i Drejtorit Menaxhues të OSSH-së dhe FPEE-së; - ndarja e borxheve sipas prejardhjes së tyre në mes të OSSH dhe FPEE; dhe - ndarja e obligimeve ligjore të mbetura (rastet gjyqësore që nuk kanë përfunduar, kontratat për blerje ose shërbime, pagesa e taksave 	<p>Komisioni i Pajtuëshmërisë.</p> <p>Bordi i Drejtorëve në KEDS aprovon.</p>	<p>Të përfundohet para se të dorëzohet kërkesa për licencë për një FPEE të re. KEDS duhet t'i dorëzoj ZRRe-së datën efektive të parashikuara për ndarjen ligjore me obligimet e paraqitura për transferimin e modifikuar të licencës 90 ditë para ndarjes ligjore efektive. Ndarja ligjore</p>	

² Plani I Veprimit përcakton vetëm veprime të pëgjithshme që duhet të ndërmerren. OSSH mund të përcaktoj planin më të detajuar të veprimit, bazuar në udhëzime për veprime nga ky plani.



	të mbetura dhe të ngjashëm).		efektive nuk duhet të jetë më vonë se 1 janar 2015 në përputhje me ligjin në fuqi.	
	Regjistrimi i subjektit të ri juridik (KEDS OSSH dhe KEDS FPEE).	Komisioni i Pajtueshmërisë.	Të përfundohet para se të dorëzohet kërkesa për licencë për një FPEE të re.	Shtojca B
	Përgatitja e organogramit të ri për KEDS OSSH dhe KEDS FPEE dhe dorëzimi i tij në ZRRE.	Komisioni i Pajtueshmërisë.	Të përfundohet para se të dorëzohet kërkesa për licencë për një FPEE të re.	ZRRE do të vlerësoj dhe aprovoj
	Në mes të KEDS OSSH dhe KEDS FPEE lidhet marrëveshja për shërbime të përbashkëta – IT, administrata, financa, prokurimi që do të kryhen nga OSSH-ja.		Të përfundohet para se të dorëzohet kërkesa për licencë për një FPEE të re.	Shtojca B
	Aplikimi në ZRRE për ndryshim në licencat ekzistuese.	Menaxhmentet e dy subjekteve.	go ditë para datës efektive të transferimit të licencës (data efektive e shthurjes)	
	Përgatitja e Planit të Pajtueshmërisë dhe dërgimi në ZRRE		Brenda go ditëve, pas hyrjes në fuqi të udhëzuesit.	Aprovimi nga ZRRE.



Shtojca B Baza ligjore dhe Interpretimi ligjor

Neni 46, i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (LRE) parasheh se *“Ndërmarrjet që kryejnë transmisionin apo shpërndarjen e energjisë elektrike do të jenë të pavarura në kuptimin e formës së tyre ligjore, organizimit dhe vendim-marrjes në pajtim me Ligjin mbi Energjinë Elektrike”*.

Për më tepër, neni 46 I LRE përcakton se *“me apo para datës 31 Dhjetor 2014, ndërmarrjet e energjisë të licencuara për aktivitetet e gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit **do të ndajnë llogaritë e tyre të brendshme për të gjitha këto aktivitete njëjloj sikur të gjitha aktivitetet në fjalë të kryheshin nga ndërmarrje të ndara, me qëllim të shmangies së diskriminimit, subvencioneve të tërthorta, si dhe çrregullimit të konkurrencës.”***

Furnizuesi publik i energjisë elektrike (FPEE) mirëmban llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar dhe furnizimin e konsumatorëve të pakualifikuar, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndërmarrje të ndara, si dhe sigurojnë se këto llogari auditohen. ZRRE monitoron zbatimin e shturjen nga ana e OSSH-së.

Fakti se neni 46 I LRE kërkon ndarjen e llogarive të brendshme *“njëlloj sikur të gjitha aktivitetet në fjalë të kryheshin nga ndërmarrje të ndara”* konfirmon se shturja e cila duhet të kryhet me ose para datës 31.12.2014, si minimum duhet të përmbaj: ndarjen e bizneseve, organizimit dhe llogarive (siç kërkohet nga Direktivat e BE-së, të pakos së II-të dhe të III-të).

Neni 15 i ligjit Nr. 03/L-201 për Energjinë elektrike (LEE) parasheh gjithashtu se kur OSSH është pjesë e ndonjë ndërmarrjeje të integruar të energjisë elektrike, *“do të jetë i pavarur nga të gjitha veprimtaritë tjera që nuk ndërlidhen me shpërndarjen, së paku sa i përket formës juridike, organizimit apo vendimmarrjes”*. Ato rregulla nuk krijojnë obligim për të ndarë pronësinë e aseteve të operatorit të sistemit të distribucionit nga ndërmarrja vertikalisht e integruar.

Për të siguruar pavarësinë e OSSH-së, neni 15 i LEE ka përcaktuar **kriteret minimale** që duhet të zbatohen:

- *“personat përgjegjës për menaxhimin e OSSH-së nuk guxojnë të jenë pjesëmarrës në strukturat e kompanive të ndërmarrjeve të integruara vertikalisht të energjisë elektrike përgjegjëse, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, për operimin ditor të prodhimit, transmisionit apo furnizimit të energjisë elektrike;*

- *duhet të ndërmerren masa të përshtatshme për t’u siguruar se interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e OSSH-së janë marrë në konsideratë në mënyrë që siguron se ata janë të aftë të veprojnë në mënyrë të pavarur;*

- *OSSH do të ketë të drejta efektive vendimmarrëse, në mënyrë të pavarur nga ndërmarrjet e integruara vertikalisht të energjisë elektrike, sa i përket aseteve të domosdoshme për të operuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar sistemin;*

- *OSSH do të ketë në dispozicion të gjitha resurset e nevojshme, përfshirë ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.*



- OSSH harton dhe ZRRE do të miratojë një program të pajtueshmërisë i cili përcakton masat të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe të sigurojë që programi të monitorohet në mënyrë adekuate.”

Neni 15 i LEE shpjegon në mënyrë të detajuar se cilat kritere duhet të plotësohen për të siguruar pavarësinë e KEDS/ OSSH nga aktivitete tjera në sektorin e energjisë (në rastin konkret nga aktivitete të FPEE-së). Asgjë në këtë nen nuk parandalon KEDS-in që, nëse i plotëson kriteret minimale të nenit 15 të LEE, të ketë në përbërjen e tij OSSH dhe FPEE si dy biznese të ndarë në baza ligjore.

Bazuar në nenin 26 të Direktivës 2009/72/EC (nga pako e III-të e EC) dhe Notës Interpretuese të Direktivës 2009/72/EC të lëshuar nga Komisioni Evropian me datë 22.01.2010, mekanizmi i shturjes ka mbetur i njëjtë si në direktivat e pakos të dytë të EC. Kjo nënkupton se si në pakon e dytë të direktivave të EC, në të cilin bazohen ligjet tona (Ligji për Rregullatorit e Energjisë dhe Ligji për Energjinë Elektrike), shturja përkufizohet në: Shturjen ligjore të OSSH-së nga aktivitetet tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarje, shturjen funksionale dhe të llogarive.

Sipas nenit të lartë cekur të Direktivës 2009/72/EC kërkohet që shpërndarja të kryhet nga një kompani e ndarë “e rrjetit” ose siç thotë direktiva “operatori i rrjetit”. Obligimi për krijimin e një kompanie të ndarë ndërlidhet vetëm për aktivitetet të operatorit të rrjetit, ndërsa aktivitetet tjera, si furnizimi dhe prodhimi mund të kryhen brenda një kompanie të vetme.

Ky nen nënkupton se nuk lejohet që Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe OSSH-së të jenë në të njëjtën kompani. Direktiva ka parashikuar ndarjen e plotë pronësore në mes tyre (gjë që për OST ka ndodhur në vitin 2006) por për OSSH-në kërkohet vetëm shturja ligjore nga aktivitetet tjera të sektorit të energjisë.

Për me tepër, në Notën Interpretuese të Direktivës 2009/72/EC thuhet : “Kompania vertikalisht e integruar, në princip është e lirë të zgjedh vetë formën ligjore për OSSH, me kusht që kjo formë ligjore të siguroj një nivel të mjaftueshëm të pavarësisë së menaxhimit të OSSH-së nga pjesë të tjera të ndërmarrjes së integruar vertikalisht, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e shturjes funksionale”.

Nota Interpretuese e Direktivës 2009/72/EC gjithashtu përcakton se “rregullat për shturje të përfshira në Direktivat e energjisë elektrike janë rregulla minimale”. Shtetet Anëtare mund të zgjerojnë këto masa me masat e mëtejshme, me synimin për të siguruar efektivitetin e shturjes.

Nota Interpretuese e Direktivës 2009/72/EC sqaron se vet Direktiva përcakton se kushtet e shturjes janë dhënë në mënyrë që t’i mundësohet çdo shteti (ose organit kompetent siç është ZRRE) të vlerësoj se cili model i shturjes është më i favorshëm për rrethana specifike të atij shteti.

Bazuar në nenin 26 të Direktivës, “OSSH duhet ta krijojë një program të pajtueshmërisë, i cili vendosë masat e ndërmarrja për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese, dhe për të siguruar monitorim adekuat të zbatimit të tij. Programi i pajtueshmërisë vendos obligime specifike të punonjësve për arritjen e atij synimi. Një raport vjetor, i cili i paraqet masat kryesore që janë ndërmarrë dorëzohet nga personi apo organi që është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë, zyrtari i pajtueshmërisë i operatorit të sistemit të shpërndarjes tek autoriteti rregullator i referuar në nenin 35(1) të Direktivës dhe publikohet. Zyrtari i pajtueshmërisë i OSSH-së është plotësisht i pavarur dhe ka qasje në të gjitha informatat e nevojshme të OSSH-së dhe të çdo ndërmarrje të bashkuar për përmbushjen e detyrave të tij”. Kur OSSH është pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht, Shtetet Anëtare sigurojnë që aktivitetet e OSSH të monitorohen nga autoritetet rregullatore në mënyrë që të



mos mund ta shfrytëzojë integrimin e vet vertikal për ta penguar konkurrencën. Në veçanti, OSSH i integruar vertikalisht, në komunikimin dhe markat e tyre, nuk duhet të krijojë lajthitje lidhur me identitetin e ndarë nga dega e furnizimit të ndërmarrjes së integruar vertikalisht.

Asgjë në EU Direktivën nuk ndalon që KEDS-i, nëse ndahet në mënyrë të duhur: biznese, llogari, stafi, asete dhe obligime/ borxhe, të ketë licenca të ndara për çdo aktivitet të energjisë, me dy tërësi që eventualisht regjistrohen në librat e regjistrimit të bizneseve, por me një Bord që i drejton ato. Në rastin konkret nuk kërkohet themelimi i Bordeve të ndara për çdo kompani. Themelimi i dy kompanive të KEDS do t'i mundësoj ZRRE-së monitorimin e duhur, andaj ZRRE do të synoj që shthurja të kryhet në këtë mënyrë ZRRE beson se me një ristrukturim të duhur dhe alokim adekuat të të punësuarve, OSSH dhe FPEE do të funksionojnë në mënyrë të duhur, siç përcaktohet në licencat e tyre.

Është me rëndësi për të sqaruar se çka është e lejuar në lidhje me shërbimet e përbashkëta (siç përdoret në Direktivën e përmendur më lartë: *“common services”*), që në fakt janë shërbime që kontrahohen në mes të operatorit të shpërndarjes dhe furnizimit publik e që *“kanë të bëjnë me personelin dhe financa, TI shërbime, transport dhe të ngjashme”*. Edhe pse këto mënyra e këtillë e organizimit të këtyre shërbimeve nuk ndalohet, ato duhet të limitohen në një numër të caktuar të aktiviteteve dhe të kontrahohen në mes të OSSH dhe FPEE menjëherë pas shthurjes.

OSSH dhe FPEE mund të kenë shërbime të përbashkëta që themelohen si njësi në kuadër të OSSH-së dhe shërbejnë edhe për FPEE-në në baza kontraktuale (marrëveshja lidhet në mes të OSSH-së dhe FPEE-së). Siç shpjegohet në Notën Interpretuese të përmendur më lartë, shërbime të tilla do të precizohen në planin e pajtueshmërisë të cilin duhet të përgatis OSSH-ja .